



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

KOMISIONI HETIMOR  
LIDHUR ME SHËRBIMET PUBLIKE TË STERILIZIMIT DHE TË CHECK-UP NË  
SHËNDETËSI

Nr. 1301 Prot.

Tiranë, më 09.04.2024

**Lënda:**

Plani i Hetimit të Komisionit Hetimor lidhur me shërbimet publike të Sterilizimit dhe të Check-up në shëndetësi

**Baza Ligjore:**

Neni 15/1, 15/2 e vijues i Ligjit Nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar.

**Drejtuar:**

**ZNJ. ALBANA VOKSHI,  
KRYETARE E KOMISIONIT HETIMOR**

**ANËTARËVE TË KOMISIONIT HETIMOR**

Në mbështetje të paragrafit 1 dhe 2, të nenit 15 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, ku specifikohet:

- 1. Pas njohjes me objektin e çështjes që do të hetohet, Komisioni nëpërmjet ekspertit ligjor/ekspertëve ligjorë, të zgjedhur nga 2/3 e anëtarëve të Komisionit, mbledh të dhëna për çështjen. Të dhënat mund të jenë informacione zyrtare dhe jo zyrtare, por që njihen publikisht*
- 2. Eksperti ligjor/ekspertët ligjorë ia raportojnë gjetjet e tyre me shkrim dhe verbalisht Komisionit si dhe propozojnë planin e hetimeve. Eksperti ligjor/Ekspertët ligjorë ndalohen të bëjnë deklaratë publike mbi gjetjet*

Pasi u njohëm më Planin Paraprak të Hetimit të publikuar nga znj. Albana Vokshi, në mbledhjen e parë të Komisionit hetimor, datë 25.03.2024, si dhe informacionet e njohura publikisht, bashkëlidhur ju dërgojmë Plani e Hetimit të propozuar nga ana jonë.



## PLANI I HETIMIT

### **I KOMISIONIT HETIMOR LIDHUR ME SHËRBIMET PUBLIKE TË STERILIZIMIT DHE TË CHECK-UP NË SHËNDETËSI**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E PREZANTUARA NË KËRKESË**

Në kërkesën e depozituar nga 1/4 e deputetëve evidentohet se:

#### **I. KONTRATA E STERILIZIMIT**

Në datën 10.12.2015, Ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj, dhe shoqëria “SaniService” sh.p.k., aksionerët e së cilës janë Investital LLC dhe kompanitë italiane “Servizi Italia”, “Tecnosanimed” dhe “U.Jet S.r.l nënshkruan kontratën për “Ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”.

Kohëzgjatja e kontratës ishte 10 vjet me një kosto totale prej 9,657,000,000 lekë (pa TVSH). Deri në fund të 2022, rezulton që për këtë kontratë të jenë paguar rreth 8 miliardë lekë ose më shumë se 80% të koston totale. Paketën më të madhe me 40% të aksioneve e zotëron Investital LLC një kompani e vogël e themeluar një muaj para nënshkrimit të kontratës me kapital 1 mijë euro në Kosovë nga Ilir Rrapaj. Aksionet e tjera zotëroheshin nga kompanitë italiane Servizi Italia me 30%, Tecnosanimed me 15% dhe U.Jet me 15%. Në një investigim të medias, u zbulua se Rrapaj u kthye në Shqipëri pas zgjedhjeve të vitit 2013 dhe para se të fitonte koncesionin, vendosi kontakte të shpeshta me ish-ministrin e Shëndetësisë, Ilir Beqaj. Po ashtu, ndërmjet Ilir Rrapaj, ish ministrit Ilir Beqaj dhe ish zv.ministrit Klodian Rrjepaj kishte njohje që përpara nënshkrimit të kontratës që ka ndikuar edhe në caktimin e fituesit të kontratës, duke përdorur një procedurë krejtësisht formale dhe fiktive, me fitues të paracaktuar. Ilir Rrapaj duket se ka pasur një rol të rëndësishëm që në fazën e konceptimit të kësaj kontrate, vendosjes së kriterëve dhe përcaktimit të procedurave që do të ndiqeshin për dhënien koncesionit kompanive të krijuara nga ana e tij. Kompanitë që rezultuan fituese u përfshinë në parapërgatitjen e dokumenteve të dhënies së koncesionit. Kriteret ligjore u përshtatën në mënyrë që të siguronin fitoren e kontratës. Studimi i fizibilitetit pati frytje artificiale dhe shumëfishimin e kostove, falsifikimin e dokumenteve dhe shifrave statistikore, llogaritje të pasakta ekonomike. Janë bërë publike udhëtimet e shpeshta, vizitat dhe kontaktet e tre personave të sipërcituar, që provojnë fiktivitetin e procedurave që u ndoqën për dhënien me koncesion të shërbimit të sterilizimit të pajisjeve mjekësore. E tërë procedura ka pasur shkelje të rënda ligjore dhe pabarazi në pjesëmarrjen në tender.



Sipas një raporti të KLSH, pajisjet me vlerë mbi 107 milionë lekë, të blera nga qeveria shqiptare përmes një kredie të Bankës së Këshillit të Europës - CEB, iu dhuruan koncesionarit pa pagesë dhe pa asnjë parashikim në kontratë.

Në lidhje me pajisjet të cilat iu dhuruan koncesionarit, në Raportin përfundimtar të auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë tereza” Tiranë, në gusht të vitit 2019, KLSH thekson:

Në zbatim të “master planit”, për “Shërbimin e sterilizimit të përqendruar ” në vitin 2011 janë blerë me “kredi” tërësisht pajisjet përkatëse, moderne, me vlerë 80,688 mijë lekë për gjithë QSUT, të cilat aktualisht janë të hapura dhe gjenden në një kat të Spitalit të Urgjencës që njihet si “Pavijoni i Sterilizimit”, **por të pavendosura në punë.**

Nga dokumentat e inventarizimit të datës 14.12.2015, konstatohet se në Polin e Integruar të Sëmundjeve të Brendëshme, në pavionin e sterilizimit ishin gjendje pajisje me vlerë 80,687,964 lekë me datë hyrje nga 27.02.2011-24.05.2011 si dhe tavolina, lavamanë, rafte me vlerë 26,918,120 lekë të bëra hyrje deri më 31.12.2012, **por të papërdorura.**

Për gjithë periudhën 2012-2016 Reparti i Sterelizimit Qendror, nuk është vënë në përdorim për përmbushjen e kërkesave në rritje për sterilizime, si dhe ofrimin e shërbimit me cilësi të lartë.

Vlera e pajisjeve të Repartit të Sterelizimit Qendror të QSUT-së, prej **25,332,638 lekë**(e llogaritur deri në Qershor 2016), e amortizuar në vite, **konsiderohet dëm i parikuperueshëm dhe humbje me efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit** por mbi të gjitha aspak në interes të shëndetit publik duke mos i shërbyer më kërkesave në rritje për sterilizime në QSUT si dhe në spitalet e tjera.

**Ndikimi:** Vlera e pajisjeve të Repartit të Sterelizimit Qendror të QSUT-së, prej **25,332,638 lekë** (e llogaritur deri në Qershor 2016), e amortizuar në vite, **konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit** por mbi të gjitha **aspak në interes të shëndetit publik** duke mos i shërbyer më kërkesave në rritje për sterilizime në QSUT si dhe në spitalet e tjera.

**Shkaku:** Mos përgjegjshmëria e titullarëve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Drejtimi i shoqërisë të marrë masa për evidentimin e përgjegjësive për efektet e krijuara.

Procedura e hartimit të dokumentave të tenderit, studimit të fizibilitetit, të conin në idenë që dhënien e shërbimit me koncesion ishte e paracaktuar që me shumë gjasa coi në hezitimin e ish-ministrit të Financave, Shkëlqim Cani për ta miratuar atë. Dy ish-ministrat shkëmbyen korrespondencë në të cilën Ministri Cani kërkoi që të argumentohej se pse ishte zgjedhur koncesioni dhe jo prokurimi i zakonshëm si dhe paralajmëroi rritjen e kostove përtej tavanëve buxhetore. “Lidhur me riskun e kërkesës, duke qenë dakord me mënyrën e përballimit të tij... do të kërkonim që Ministria e Shëndetësisë të marrë të gjitha masat e duhura, që ky risk të minimizohet sa më shumë që të jetë e mundur përgjatë periudhës së koncesionit,” shkruante Ministri i Financave Shkëlqim Cani në janar 2015. Megjithëse Ministria e Shëndetësisë nuk dërgoi asnjë dokumentacion shtesë, Ministri Cani e miratoi kontratën me kushtin që *financimi i projektit të respektonte në mënyrë rigorozë limitin buxhetor të parashikuar për këto shërbime.*

Ndryshe nga parashikimi në studimin e fizibilitetit, Ministria e Shëndetësisë ka tejkaluar tavanet buxhetore dhe paguan çdo vit një faturë shumë më të shtrenjtë sesa investimi fillestar i



pretenduar prej 11 milionë eurosh. KLSH gjithashtu në një vlerësim të tij thekson se, kontrata e sterilizimit është hartuar në kushte favorizuese vetëm për koncesionarin dhe pritet të sjellë probleme në vazhdimësi për financimin e saj.

Deri në fund të 2022, koncesionari është paguar me rreth **76 milion Euro (pothuajse sa ishte fondi limit kur u nënshkrua kontrata koncesionare)**. Cka dëshmon qartë që vlera reale e këtij koncesioni ka kapërcyer cdo limit parashikimi duke pothuajse shteruar buxhetin e Fondit, e duke sjellë pasoja shumë të mëdha në shëndetësi:

- Është reduktuar buxheti për sektorët e tjerë të shëndetësisë (parësori)
- Në shumë raste është dhënë urdhër që të ndërpriten ndërhyrjet kirurgjikale (për shkak të tejkalimit të buxhetit të planifikuar mujor) përvec emergjencave, duke sjellë pasoja të rënda në shëndetin dhe jetën e qytetarëve.
- Në dy maternitetet e Tiranës, Koço Gliozheni dhe Mbretëresha Geraldinë, janë rikthyer instrumentet tradicionale për një pjesë të madhe të lindjeve natyrale. Metoda e vjetër e sterilizimit me autoklavë funksionin gjithashtu në gjysmë-ilegalitet, pas kërkesave verbale të eprorëve për të ulur përdorimin e seteve.

Pagesat për Sterilizimin zënë rreth 37% të totalit të Konçesioneve të Shëndetësisë.

Sipas denoncimit publik të bërë nga ana e mjekëve, cmimi për një set u rrit më rreth 80 herë. Kontrata e koncesionit për sterilizimin e pajisjeve kirurgjikale **nuk ka një çmim tavan** dhe bazohet në parimin *pay per use*. **Pra sa më shumë sete kirurgjikale përdoren aq më tepër rritet faktura.**

Sipas mjekëve kirurgë, **në shumë operacione, një pjesë e mjeteve nuk gjejnë përdorim** duke shkaktuar në këtë mënyrë një kosto të pajustificuar, gjithashtu shumë sete kanë qenë jo të sigurt pa u hapur ende paketimi.

Vendimet e Drejtuesve të FSKDSH që shërbimi i sterilizimit të nivelit të lartë dhe të kushtueshëm të shtrihet përtej sallave të operacioneve, duke mbuluar çdo material ambulator të sterilizuar me avull apo me temperaturë të ulët, që përdoret për mjekim plagësh, ndërrim fasho, prerje të lehta etj si dhe Amendimmi i termave të Kontratës së Koncesionarit në 2020 kanë çuar në rritje të kostove të këtij koncesioni përtej parashikimeve fillestare të këtij shërbimi.

Referuar auditimit të kryer nga KLSH në vitin 2019, thuhet shprehimisht se: “Nga auditimi i përmbushjes së përgjegjësisë lidhur me monitorimin dhe likuidimin e shërbimit të integruar të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile dhe furnizim me materiale mjekësore sterile, rezultoi se këtë viti, krahasur me një vit më parë, vlera e këtij shërbimi është rritur me 954 milion lekë, ose 84% më shumë se një vit më parë, rritje e paparashikuar dhe jashtë parashikimeve të institucionit duke krijuar detyrim të prapambetur në vlerën 306 milion lekë. Nuk konstatohet që kjo rritje të ketë vënë në lëvizje strukturat përgjegjëse për të analizuar faktorët dhe për të marrë masa për të mbajtur këtë lloj shpenzimi nën kontroll, por pa krijuar probleme në shërbimin ndaj qytetarit.”.



Më herët në një audit të kryer në vit 2018, KLSH kishte rekomanduar rishikimin e nenit 19.5 të kontratës, pasi shpenzimet që krijonte shërbimi i sterilizimit për furnizimin me energji dhe ujë, i ngarkoheshin Buxhetit të Shtetit. Konkretisht, KLSH shprehej se: “Nga auditimi në Spitalin Universitar të Traumës konstatohen rritje të shpenzimeve të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2016 në vlerën 20,974,442 lekë dhe për vitin 2017 në vlerën 25,021,955 lekë, respektivisht më tepër 4,047,513 lekë.”.

Problematikat kanë vazhduar të evidentohen edhe në auditimin e kryer nga KLSH gjatë vitit 2023, ku thuhet shprehimisht se: “Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës së Koncesionit nr. 1440/33, datë 10.12.2015 “PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore”, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shoqërisë Koncesionare “S.” SHPK, ka rezultuar se, për ndërhyrjet kirurgjikale të kryera gjatë vitit 2022, në tre llojet e spitaleve, universitare, rajonale dhe bashkiake, ka përdorim të seteve të ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale, në 15,339 raste në Spitale Universitare; në 8,708 raste në Spitalet Rajonale dhe në 55 raste në Spitalet Bashkiake.

Niveli i lartë i deviacioneve, ku për të njëjtën tipologji kirurgjikale përdoren nivele të ndryshme të kompleksitetit të seteve, ku në spitalet universitare arrin deri në 52% të rasteve, në spitalet rajonale deri në 48.5% të rasteve, kundrejt totalit të ndërhyrjeve, reflekton mangësitë në përfshirjen e kirurgjive sipas tipologjisë, referuar nivelit të seteve, por edhe të përmbajtjes me instrumente mjekësore të seteve referuar nivelit të kompleksitetit, gjë e cila është e shoqëruar edhe me rritjen e kostove të këtij shërbimi dhe për rrjedhojë të mbështetjes buxhetore për vazhdimësinë.

Rikonfigurimi i tyre edhe pas ndryshimeve në vitin 2020, referuar aneksit nr. 4 të kontratës nr. 1440/40, datë 10.12.2015, dhe shkresës nr. 28/20, datë 04.12.2020 të koncesionarit, protokolluar në MSHMS me nr. 150/21, datë 07.12.2020 me objekt “Konfigurim i seteve 30.11.2020”, ka paraqitur mangësi dhe nuk ka minimizuar problematikën e evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.”

Në vitin 2022, është respektuar tavani buxhetor për financimin e shërbimit të sterilizimit në shumën 1,700,000 mijë lekë. Megjithatë, po ti referohemi vlerës totale të këtij shërbimi sipas Kontratës në shumën 9,657,000 mijë lekë pa TVSH dhe 11,588,400 mijë lekë me TVSH, për 10 vjet, rezulton se buxheti vjetor duhet të jetë jo më shumë se 1,158,840 mijë lekë me TVSH, ç’ka do të thotë se kemi tejkallim të tij, pavarësisht se projeksioni për numrin total të ndërhyrjeve me 63,000 raste nuk është tejkalluar. Referuar dhe të dhënave të viteve të mëparshme rezulton se këto shpenzime janë me trend rritës. Kështu, shpenzimet faktike në vitin 2020 janë në shumën 1,288,269 mijë lekë, në vitin 2021, në shumën 1,500,924 mijë lekë dhe në vitin 2022 në shumën 1,699,975 mijë lekë, duke paraqitur rritje të nevojës për financim përtej parashikimeve. Po kështu ky trend është reflektuar edhe në PBA 2022-2024, ku plani buxhetor për PPP-Sterilizimi është planifikuar me 20,000 mijë lekë më shumë nga viti në vit. Rritja e përdorimit të seteve kirurgjikale të kompleksitetit të lartë dhe të mesëm kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve me 13 % më shumë se në vitin 2021



*Përcaktimi i mënyrës së pagesës sipas faturës së lëshuar nga koncesionari me TVSH, nuk është në përputhje me: Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (i shfuqizuar), neni 25/11 “Barnat dhe shërbimi shëndetësor” ku cilësohet: “Nga data 1 prill 2014, furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i përjashtuar. Ministri i Financave përcakton me udhëzim, para datës 01.04.2014, mënyrën se si veprohet lidhur me sasinë e barnave që rezultojnë gjendje në datën 01.04.2014. Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Kreu VIII “Përjashtimet, furnizimet me shkallë zero, eksportet seksioni 1 “furnizimet e përjashtuara”, neni 51 “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm”, germa c, ku cilësohet: Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet me interes të përgjithshëm si më poshtë:*

*Sa më sipër, angazhimi i fondeve buxhetore për likuidim TVSH-je, në masën 20 % të tyre, apo në shumën 417,175 mijë lekë, ka sjellë që përdorimi i këtyre fondeve të mos shkojë në destinacionin e përcaktuar, që është ofrimi i shërbimeve mjekësore. Për rrjedhojë nëse TVSH e paguar për sterilizimin në vitin 2022, do të përdorej në destinacionin e duhur do të ishin kryer edhe 12,705 ndërhyrje kirurgjikale të kompleksitetit të mesëm më shumë. Ndryshimi i destinacionit të fondeve ka sjellë uljen e nivelit të shërbimit, po të konsiderojmë dhe faktin që ky shërbim është realizuar në masën 100 % të buxhetit të planifikuar, ç’ka do të thotë që tavani buxhetor ka kufizuar dhënien e shërbimit.*

*Gjithashtu në raportin e auditimit “Për verifikimin e zbatimit e rekomandimeve të lëna në auditimet e maprshme të evaduar në periudhën 01.07.2021 – 31.12.2021, KLSH vendos theksin në problematikat në vijim:*

*Nga ana e drejtorisë së SRSH nuk është marrë miratim nga MSH, për përdorimin e autoklavës, krahas shërbimit të koncesionarit, duke vepruar në mospërputhje me termat e kontratës koncesionare të lidhur midis MSH dhe Koncesionarit. Nuk ka evidence në lidhje me ndërhyrjet në sallat kirurgjikale me setet e sterilizuara në autoklavën e spitalit, duke e bërë të vështirë për të përcaktuar setet e përdorura nga koncesionari apo Spitali. Raportimi periodik i SRSH për FDSKSH mbi numrin ndërhyrjeve kirurgjikale të realizuara nga koncesionari për rastet e planifikuar dhe rasteve të urgjencës, gjatë vitit 2018, 2019 është raportuar sipas sektorit të kostos në SRSH vetëm numri total i ndërhyrjeve dhe jo të ndara sipas nivelit të kompleksitetit të ndërhyrjeve, veprim ky në mospërputhje me parashikimet e kontratës. Sektori i kostos në SRSH has vështirësi për të pasqyruar saktë numrin e seteve të përdorura të koncesionarit pasi në regjistrin e operacioneve nuk ka ndarje për instrumentet dhe setet kirurgjikale të sterilizuara dhe nga autoklava e SRSH.*



## II. KONTRATA E CHECK-UP

Në datën 07.01.2015, Ministria e Shëndetësisë dhe shoqëria “3P Life Logistic” sh.p.k., nënshkruan kontratën për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40 – 65 vjeç. Kjo kontratë do të ketë një kohëzgjatje 10-vjeçare dhe përlllogarit me një kosto totale rreth 120 milionë euro. Deri më sot rezulton që për këtë kontratë të jenë paguar rreth 60 milionë euro.

Në fazën e përzgjedhjes së fituesit dhe lidhjes së kontratës, rezulton se Ministria e Shëndetësisë, e drejtuar asokohe nga ish-ministri Ilir Beqaj, shpalli fitues ofertuesin me cmimin më të lartë (bashkimin e shoqërisë Marketing&Distribution dhe Trimed – të dyja kompanitë zotërohen nga biznemenia Vilma Nushi, e njohur për afërsinë e saj me qeverinë dhe financimin e Partisë Socialiste, ndaj mendohet që rezultati i kësaj procedure ka qenë i paracaktuar). Këto subjekte tregtare kishin ofertuar rreth 20% më shtrenjtë se operatorët ekonomikë të tjerë në garë, duke i kushtuar shtetit rreth 24 milionë euro më shumë. Sikur kjo të mos mjaftonte, rezulton se asnjëra prej 2 shoqërive fituese nuk kishte eksperiencë pune në kontrollin shëndetësor të popullsisë, madje subjekti Marketing&Distribution ka për objekt të veprimtarisë shitjen e pijeve alkoolike dhe duhanit, që sigurisht janë të dëmshme për shëndetin.

Në fazën e zbatimit të kontratës së check-up, rezulton se sipas një auditimi të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, rezulton se gjatë tri viteve të para 2015 – 2018, janë paguar 930 milionë lekë për shërbime të pakryera, të cilat të marra së bashku me shumën prej 352 milionë lekë për periudhën 2016 – 2020, të kryer për koncesionin e hemodializës, arrijnë në shumën totale 1.3 miliardë lekë ose 10.5 milionë euro. Kryerja e pagesave për shërbime të pakryera vjen si pasojë e parashikimit në kontratë të një projekcioni kontrollesh mjekësore bazë, të cilat në tre vitet e para rezultojnë të mos jenë kryer. Pikërisht si rezultat i këtyre pasojave tepër negative për Buxhetin e Shtetit, KLSH ka kërkuar që të rishikohet kontrata koncesionare, me qëllim që të minimizohen pasojat negative për buxhetin duke theksuar shprehimisht:

*Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës së kontrollit bazë **CHECK-UP**, rezultoi se, edhe këtë vit nuk janë arritur projeksionet e kontratës duke bërë që, pagesat e marrë tepër nga koncesionari, për punën e pa kryer për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018, të arrijnë në 925 milion lekë. Megjithëse KLSH, në auditimet e mëparshme ka kërkuar që, koncesionari të paguhen vetëm për kostot fikse për rastet e pa kryera dhe jo vlera e shpenzimeve variabël, të cilat nuk ndodhin në rastin e një kontrolli bazë të pakryer, konstatohet se edhe këtë vit është vazhduar si vitet e mëparshme, duke sjellë rritje pa të drejtë të kostove buxhetore për këtë shërbim. Gjithashtu këtë vit, si edhe vitet më parë të implementimit të këtij shërbimi, për shkak të mosveprimit të strukturave shtetërore, vijohet të trajtohet edhe me TVSH, duke i sjellë shtetit një kosto shtesë të konsiderueshme, kështu:*

*Për vitin 2018, kjo kosto shtesë llogaritet për **168 milion lekë** (22 milion lekë për shpenzimet variabël të kontrolleve të pa realizuara dhe 146 milion lekë TVSH-ja e faturuar e këtij shërbimi). Për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës (2015-2018), kosto shtesë llogaritet për **801 milion lekë** (241 milion lekë për shpenzimet variabël të kontrolleve të pa realizuara dhe 560 milion lekë TVSH-ja e faturuar e këtij shërbimi). Duhet thënë se në rastin e TVSH ka një*



mosveprim të unifikuar të disa institucioneve shtetërore të cilat pasojnë përgjegjësitë nga njëri tek tjetri.

-----  
**4.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe MSHMS, në bashkëpunim me Strukturat drejtuese të Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, të bëjnë të mundur **rishikimin e kontratës koncesionare me PPP** të shërbimit bazë **Check-up**, me shoqërinë koncesionare **“3P” shpk**, për të gjitha problematikat e konstatuara për kohëzgjatjen e deritanishme por edhe mbi një analizë të thelluar dhe shteruese të probleme që lidhen me implementimin e kësaj kontrate në vijimësi. Të ketë një vendimarrje të kujdesshme dhe shteruese pasi ndërhyrjet e shpeshta tregojnë për nivel të ulët të seriozitetit të punës së strukturave shtetërore.

E njëjta gjetje është konfirmuar edhe nga një raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2022, ku në faqet 185 – 186 thuhet shprehimisht se: “Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës së Koncesionit të Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB/Check-up) me nr. 3082/20 prot., datë 07.01.2015, të lidhur midis MSHMS dhe Shoqërisë Koncesionare “3P” SHPK, ka rezultuar se, janë kryer pagesa në shumën 876,090 mijë lekë për 454,828 kontrolle të kryera, nga 876,090 mijë lekë për 475,000 kontrolle të planifikuara referuar projekcionit. Vlera e shërbimit për 454,828 rastet e KMB të kryera gjatë vitit 2022, rezulton në shumën 838,885 mijë lekë me TVSH.

**Edhe në vitin 2022, si në vitet e mëparshme që prej fillimit të zbatimit të kësaj kontrate, janë likuiduar fatura referuar numrit të projektuar të KMB sipas kontratës dhe jo sipas numrit faktik të kryer, për rrjedhojë është faturuar shërbim i pakryer për 20,172 raste, me një kosto në shumën 37,198 mijë lekë me TVSH.**

Gjithashtu, nga analizimi i disa treguesve ka rezultuar se, pavarësisht shtimit të numrit të KMB në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, sëmundjet kronike janë shtuar me 8,603 raste, vlera e rimbursimit të barnave për shkak të rritjes së sëmundshmërisë dhe kompleksitetit të tyre me 1,184,831 lekë më shumë; rritja e numrit të shtrimeve në spitale me 18,979 raste më shumë, rritja e vizitave ambulatorë në Spitalet Universitare dhe Bashkiake me 123,354 raste më shumë etj., tregojnë se efektet e masës profilaktike “Kontroli Mjekësor Bazë”, nuk janë reflektuar në rezultate konkrete, në uljen e sëmundshmërisë së popullatës, duke cënuar efektshmërinë e përdorimit të këtyre fondeve.”.



## II. PLANI I HETIMI

### A. Objekti:

Sipas vendimit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit lidhur me Shërbimin Publik të Sterilizimit dhe Shërbimin Publik të Check-up në Shëndeti, objekt i veprimtarisë së komisionit është:

1. **Shqyrtimin e çështjeve të lidhura me kontratat publike për shërbimin publik të sterilizimit dhe atë të check-up në shëndetësi, si dhe zbatimin e tyre;**
2. **Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrje ligjore në legjislacionin përkatës.**

Hetimi do të synojë kontrollin e zbatimit të ligjeve në fuqi nga organet dhe funksionarët publike, nxjerrjen e përgjegjësive institucionale dhe vlerësimin e nevojës për miratimin, shfuqizimin, ndryshimin e dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e ofrimit të shërbimeve cilësore në shëndetësi, me kosto sa më të ulëta për Buxhetin e Shtetit dhe qytetarët.

Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, vecanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe i respektimit të jetës private të individit.

Hetimi do të realizohet në drejtim të sqarimit të mënyrës së zbatimit të ligjit, identifikimit të përgjegjësive të organeve apo personave zyrtarë përkatës në procedurat për lidhjen dhe zbatimin e kontratave publike të sterilizimit dhe check-up, analizimit të gjetjeve për të përgatitur rekomandimet për ndërhyrje ligjore e administrative për parandalimin apo eliminimin plotësisht të shkeljeve ligjore në të ardhmen.

Konkretisht, hetimi do të përqendrohet në:

- i) Kuadrin ligjor që rregullon lidhjen e kontratave për shërbimin publik të sterilizimit dhe check-up në shëndetësi;
- ii) Shkeljet e këtij kuadri ligjor gjatë procedurave për përzgjedhjen e fituesit dhe lidhjen e kontratave publike të sterilizimit dhe check-up;
- iii) Cilat kanë qenë organet a funksionarët publikë të ngarkuar me përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë dhe lidhjen e kontratave publike të sterilizimit dhe check-up?
- iv) Cilat kanë qenë organet a funksionarët publikë të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave publike të sterilizimit dhe check-up?
- v) Si i kanë kryer këto organe/funksionarë detyrat që iu ngarkonte Kushtetuta, ligji, aktet nënligjore dhe kontratat publike?
- vi) A kanë kryer shkelje? Nëse po, cilat janë këto shkelje dhe cilat arsye/motivet që këto subjekte kanë kryer shkelje të Kushtetutës, ligjit, akteve nënligjore apo dispozitave kontraktore?

## **B. Detyrat e Komisionit dhe veprimet e tij:**

**Detyrat e Komisionit** janë:

- (1) Kontrolli i veprimeve dhe mosveprimeve të organeve dhe funksionarëve publikë të përfshirë në procedurat për lidhjen dhe zbatimin e kontratës publike të shërbimit të sterilizimit;
- (2) Kontrolli i veprimeve dhe mosveprimeve të organeve dhe funksionarëve publikë të përfshirë në procedurat për lidhjen dhe zbatimin e kontratës publike të shërbimit të check-up;
- (3) Verifikimi i shkeljeve ligjore dhe pasojave që kanë pasur këto shkelje në Buxhetin e Shtetit;
- (4) Verifikimi i pasojave që ka pasur secila prej shkeljeve në ofrimin e shërbimeve cilësore në shëndetësi për qytetarët;
- (5) Vlerësimin e nevojës për ndërhyrje ligjore, me qëllim që të garantohet ofrimi i shërbimeve cilësore në shëndetësi për qytetarët dhe të mbrohet Buxheti i Shtetit nga abuzimi i fondeve publike;
- (6) Përgatitja e rekomandimeve për marrjen e masave administrative dhe ligjore, si dhe në rast se konstatohet kryerja e veprave penale, njoftimi i prokurorisë për fillimin e çështjes penale.

Për përmbushjen e këtyre detyrave, komisioni:

- 1) miraton planin e hetimeve;
- 2) mbledh të dhëna për çështjen, të cilat mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, por që njihen publikisht;
- 3) thërret dëshmitarë për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen;
- 4) në shërbim të hetimeve mbi çështjen, administron dokumente zyrtare, si dhe të dhëna të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e hetimeve;
- 5) për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen, thërret ekspertë të njohur nga gjykata për fusha të ndryshme.

Në mbështetje të neneve 14/b, 15/1 dhe 17 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Për Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit lidhur me Shërbimin Publik të Sterilizimit dhe Shërbimin Publik të Check-up, do të kërkohet nga disa institucione shtetërore, që të vendosin në dispozicion informacionet/dokumentat që disponojnë për objektin e hetimit. Konkretisht, do të kërkohen ndër të tjera, por pa u kufizuar vetëm në to, dokumentet apo informacionet e mëposhtme:

1. Informacione apo dokumente nga Kryeministria, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe institucioneve në varësi, institucionet e drejtësisë (prokurori dhe gjykata) Agjencia e Prokurimit Publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, QSUT, të gjithë Spitaleve, etj lidhur me të gjitha procedurat e ndjekura për lidhjen dhe zbatimin e kontratës publike të sterilizimit;
2. Informacione apo dokumente nga Kryeministria, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e



- Përgjithshme e Gjendjes Civile si dhe institucioneve të tjera në varësi, institucionet e drejtësisë (prokurori dhe gjykata), Agjencia e Prokurimit Publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, QSUT, të gjithë Spitaleve, të gjitha Qendrave Shëndetësore, etj lidhur me të gjitha procedurat e ndjekura për lidhjen dhe zbatimin e kontratës publike të check-up;
3. Çdo informacion tjetër të nevojshëm për përmbushjen e detyrave nga ana e Komisionit, sipas objektit të punës së Komisionit.

Komisioni Hetimor përveç marrjes së informacioneve zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të përdorë të gjitha metodat e hetimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë kqyrjen, kontrollin apo sekuestrimin e akteve pranë institucioneve përgjegjëse. Komisioni do të administrojë të gjitha raportet që i referohen çështjeve, që janë objekt i veprimtarisë së tij.

Komisioni rezervon të drejtën, që në përputhje me nevojat që do të dalin gjatë hetimit, si dhe bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, të caktojë ekspertë të fushave të shëndetësisë, IT, drejtësisë dhe ekonomisë.

## LISTA E DËSHMITARËVE

Në kuadër të analizës së plotë mbi këtë çështje, sugjerojmë të thirren për të dëshmuar në Komisionin Hetimor, personat apo funksionarët publik të mëposhtëm:

Emër, Mbiemër	Funksioni
Edi Rama	Kryeministër i Shqipërisë
Ilir Beqaj	Ish-Ministër i Shëndetësisë
Ogerta Manastirliu	Ish-Ministre e Shëndetësisë
Shkëlqim Cani	Ish Ministër i Ekonomisë dhe Financave
Anila Denaj	Ish Ministër i Ekonomisë dhe Financave
Albana Kociu	Ministre e Shëndetësisë
Klodian Rrjepaj	Ish-Zv.ministër i Shëndetësisë
Geraldina Prodani	Ish Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë
Endri Tafani, Pano Soko, Artan Koni	Nisma Thurje
Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe zyrtarë të tjerë që kanë dijeni rreth objektit të hetimit, dhe që rezultojnë të përfshirë në këtë çështje	
Ortakët dhe administratorët e të dy kontratave koncesionare të Check up dhe Sterilizimit	
Drejtorët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor që nga firmosja e kontratave të financimit dhe nisja e zbatimit të dy kontratave koncesionare	
Drejtuesit e Qendrave Spitalore Universitare dhe të gjithë spitaleve që nisja e zbatimit të koncesionit të sterilizimit	
Kryetarët / Anëtarët e Komisioneve për Dhënie të Koncesioneve të Check up dhe sterilizimit	
Anëtarët e KPP që kanë trajtuar ankimet në procedurat e dhënies së dy koncesioneve	
Drejtuesit e APP	
Avokatura e Shtetit	
- Komisioni të rezervojë të drejtën që në Planin e Hetimit të thërrasë për të dëshmuar çdo person apo funksionar tjetër që ka dijeni rreth objektit të hetimit, dhe që rezulton i përfshirë në këtë çështje nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar.	



**C. Afati i zhvillimit të hetimeve dhe përfundimit të tij:**

Pas vonesave të shkaktuara nga mungesa e mbledhjes së Komisionit, sugjerojmë që plani paraprak i hetimeve të ndryshojë afatet si më poshtë vijon:


<b>Veprimet</b>	<b>Afati maksimal</b>
Mbledhja e dokumentacionit	Brenda datës 15 Prill 2024
Shqyrtimi paraprak i dokumentacionit dhe vlerësimi i nevojës për dokumentacion shtesë – Miratimi i Planit të Hetimit	Brenda datës 20 Prill 2024
Pyetja e dëshmitarëve	Brenda datës 10 Qershor 2024
Analizimi i akteve dhe dokumentave	Brenda datë 25 Qershor 2025
Shqyrtimi përfundimtar dhe nxjerrja e konkluzioneve të hetimit – Mbyllja e Hetimit	Brenda datës 15 Korrik 2024
Prezantimi i Raportit Final të Komisionit	Brenda datës 20 Korrik 2024.

**D. Hartimi i Planit të Hetimit:**

Mbi bazën e Planit Paraprak të Hetimit të publikuar nga Kryetarja e Komisionit Hetimor znj. Albana Vokshi, i kërkojmë Kryetares së Komisionit që t'i propozojë Komisionit Hetimor për miratim projektvendimin "Për miratimin e Planit të Hetimit të Komisionit Hetimor".

**EKSPERTËT:**

MERI LIKA



FRANCI NURI

